



ProCredit Bank

Udhëzues për Prokurimin e Qëndrueshëm

ProCredit Bank Shqipëri

Në përputhje me Udhëzimin e grupit Procredit për Prokurimin e Qëndrueshëm



Përmbajtja:

1	Qëllimi, përdorimi dhe fusha e këtij dokumenti.....	3
2	Përkufizimi i furnitorit.....	4
3	Parimet bazë.....	4
3.1	Zbatimi i parimeve bazë.....	5
4	Analiza e qëndrueshmërisë së furnitorëve.....	5
4.1	Rëndësia e furnizimit.....	5
4.2	Furnitorët e përjashtuar nga vlerësimi i qëndrueshmërisë..	6
4.3	Kriteret e qëndrueshmërisë.....	6
4.3.1	Kritere negative.....	6
4.3.2	Kritere të qëndrueshmërisë.....	6
4.3.3	Qëndrueshmëria e produktit.....	7
4.4	Sistemi i pikëzimit.....	9
4.5	Procesi i vlerësimit.....	9
5	Kërkesat për raportim.....	9

1. Qëllimi, përdorimi dhe fusha e këtij dokumenti

1.1 Qëllimi i udhëzuesit dhe përgjegjësitë

Qëllimi i këtij dokumenti është të përcaktojë bazën për prokurimin e qëndrueshëm brenda ProCredit Bank dhe të shërbejë si një udhëzues gjithëpërfshirës për vlerësimin dhe menaxhimin e qëndrueshmërisë së furnitorëve.

Ne e njohim faktin që ndikimet etike, sociale dhe mjedisore gjenden brenda zinxhirëve të furnizimit të kompanive; megjithatë, ne besojmë gjithashtu se ndikime pozitive mund të arrihen përmes blerjes së mallrave dhe/ose shërbimeve më të përgjegjshme dhe përmes bashkëpunimit me furnitorët për të ndikuar në mënyrë pozitive performancën etike, sociale dhe mjedisore të ndërsjellë. ProCredit Bank synon për këtë arsye të favorizojë furnitorët e qëndrueshëm dhe të inkurajojë ata që ende nuk janë fokusuar në qëndrueshmëri që të adoptojnë praktika të tilla.

1.2 Fusha dhe struktura e udhëzuesit

Ky udhëzues zbatohet për të gjitha institucionet ProCredit, duke përfshirë bankat, Akademinë ProCredit dhe të gjitha zyrat e Quipu. Për më tepër, ai zbatohet për të gjithë furnitorët që përfshihen në përkufizimin e termit “furnitor” siç përdoret në këtë dokument.

Udhëzuesi ndahet në seksionet e mëposhtme:

- Përkufizim i përgjithshëm i termit “furnitor”
- Parimet bazë të zbatueshme për të gjithë furnitorët
- Dallimet midis furnitorëve të rëndësishëm dhe jo të rëndësishëm
- Hapat që duhen ndërmarrë për të vlerësuar më tej qëndrueshmërinë e furnitorëve të rëndësishëm
- Procesi i detyrueshëm i raportimit

2. Përkufizimi i furnitorit

Furnitori përcaktohet si një palë që furnizon mallra ose shërbime sipas nevojave të institucionit. Çdo shpenzim që nuk lidhet drejtpërdrejt me një produkt ose shërbim të caktuar nuk konsiderohet marrëdhënie me furnitor. Në praktikë, ky përkufizim përjashton sponsorizimet, tarifat e paguara institucioneve financiare ndërkombëtare në lidhje me shërbimet financiare që ne ofrojmë, tarifat e anëtarësimit, donacionet dhe shpenzimet e detyrueshme shtetërore.

3. Parimet bazë

Të gjithë furnitorët priten të respektojnë vlerat kryesore të ProCredit Bank. Prandaj, Kodi i Sjelljes përbën bazën për çdo marrëdhënie biznesi me një furnitor potencial. Kjo përfshin pranimin e qartë të parimeve tona dhe angazhimin për t'i respektuar ato në të gjitha aspektet e ndërveprimeve tona të biznesit.

Furnitorët duhet të ndjekin parimet themelore të mëposhtme:

- Pajtueshmëria me Listën Përjashtimore të ProCredit: Furnitorët dhe kontraktorët priten të shmangin përfshirjen në çfarëdo lloji aktiviteti të listuar në Listën Përjashtimore të ProCredit.
- Parandalimi i pastrimit të parave: Furnitorët priten të respektojnë vlerat etike të ProCredit Bank dhe të konfirmojnë se nuk marrin pjesë në asnjë formë të pastrimit të parave.
- Parandalimi i korrupsionit dhe mashtrimit: Rryshfetet dhe/ose korrupsioni nuk tolerohen dhe për këtë arsye nuk mund të vendoset ose vazhdojë asnjë marrëdhënie biznesi nëse furnitori potencial dihet të jetë i përfshirë në korrupsion dhe/ose mashtrim.
- Respektimi i të drejtave të njeriut: Grupi ProCredit, përfshirë ProCredit Shqipëri, ndjek Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut (1948) dhe pret që furnitorët dhe kontraktorët të veprojnë në përputhje me të.

- Shëndeti, siguria, mbrojtja dhe mjedisi (HSSE): Furnitorët pritet t'i trajtojnë me seriozitet çështjet HSSE duke siguruar përditësimin dhe pajtueshmërinë me të gjitha ligjet dhe rregulloret përkatës.

3.1 Zbatimi i parimeve bazë

Para se të fillojë një marrëdhënie me një furnitor, personi përgjegjës për porosinë siguron që aktivitetet e furnitorit potencial janë në përputhje me parimet bazë. Marrëdhënia me furnitorin ndërpritet menjëherë nëse zbulohet mospërputhje në çdo moment.

4. Analiza e qëndrueshmërisë së furnitorëve

4.1 Rëndësia e furnizimit

Shtirja e analizës së qëndrueshmërisë së zinxhirit të furnizimit përcaktohet duke vlerësuar rëndësinë e nevojës për prokurim. Vlerësimi kryhet duke marrë parasysh shpenzimin e pritshëm në lidhje me nevojën e prokurimit dhe nëse mallrat ose shërbimet do të ofrohen nga një furnitor kyç ose jo kyç.

Furnitorët kyç janë partnerë kontraktualë që ofrojnë mallra ose shërbime të domosdoshme për operacionet e biznesit, ndërsa furnitorët jo kyç mbështesin aktivitetet e përditshme të kompanisë.

Rëndësia e furnitorit përcaktohet si vijon:

	Furnitor kyç	Furnitor jo kyç
Shpenzim i ulët	Jo i rëndësishëm	Jo i rëndësishëm
Shpenzim i mesëm	I rëndësishëm	Jo i rëndësishëm
Shpenzim i lartë	I rëndësishëm	I rëndësishëm

Vetëm furnitorët që ofrojnë mallra ose shërbime të klasifikuara si “të rëndësishme” i nënshtrohen analizës së qëndrueshmërisë, për shkak të ndikimit të tyre të madh në operacionet tona.

4.2 Furnitorët e përjashtuar nga vlerësimi i qëndrueshmërisë

Furnitorët me karakteristikat e mëposhtme janë të përjashtuar nga analiza e qëndrueshmërisë:

- Kompani me një person ose “freelancer”, përfshirë bashkëpronarë të një kompanie pa punonjës të tjerë.
- Furnitorë për të cilët nuk ka alternativa, si mallra ose shërbime të rregulluara publikisht (p.sh. furnizimi me ujë në një zonë të caktuar).

4.3 Kriteret e qëndrueshmërisë

Qëndrueshmëria duhet të vlerësohet përmes kriterëve të përcaktuara më poshtë, duke filluar me kriteret negative dhe më pas me kriteret mjedisore dhe sociale.

4.3.1 Kriteret negative

Furnitorët duhet t'i nënshtrohen një procesi të verifikimit në media/lajme për të zbuluar aksidente, incidente, dëmtime të konsiderueshme të mjedisit në çfarëdo forme dhe/ose shkelje të të drejtave të njeriut.

4.3.2 Kriteret e qëndrueshmërisë

Kriteret e mëposhtme ofrojnë një kuadër gjithëpërfshirës për ekipet e prokurimit për të vlerësuar angazhimin e një furnitori ndaj praktikave të përgjegjshme mjedisore dhe sociale.

Tabela 1: Kriteria të qëndrueshmërisë

Nr	Kriteret
1	Kushtet e punës
2	Procedurat e shëndetit dhe sigurisë në punë
3	Diverse dhe përfshirje
4	Sistemi i menaxhimit të mjedisit të brendshëm
5	Sistemi i menaxhimit të energjisë
6	Përdorimi i energjisë së rinovueshme në operacionet të veta
7	Certifikimi i ndërtesave
8	Menaxhimi i mbeturinave
9	Përgjegjësia shoqërore e korporatës
10	Qëndrueshmëria e produktit

4.3.3 Qëndrueshmëria e produktit

Në çdo institucion të ProCredit, përfshirë bankën ProCredit Shqipëri, prokurimi i mallrave të cilët konsiderohen “të rëndësishme” i nënshtrohet një vlerësimi të qëndrueshmërisë. Kjo kryhet sipas kriterëve të përzgjedhjes të përcaktuara brenda institucionit.

Tabela 2: Kriteret e qëndrueshmërisë për mallra specifike

Produkt/shërbim	Kuadri i zinxhirit të furnizimit të qëndrueshëm
Letra	Letër e ricikluar që nuk i është nënshtruar zbardhimit me klor, ose letër nga pyje të menaxhuara në mënyrë të qëndrueshme, e certifikuar nga një organizatë e besueshme palë e tretë.
Furnizime afatshkurtra zyre	Artikuj të prodhuar nga materiale të ricikluara ose organike që mund të rimbushen ose që mbajnë certifikime të qëndrueshmërisë.
Pajisje elektronike	Pajisje të certifikuara nga Energy Star; marka që ofrojnë programe rikthimi ose riciklimi për pajisjet e tyre; pajisje të qëndrueshme që mund të përmirësohen ose riparohen lehtësisht për të zgjatuar jetën e tyre. Duhet t'i jepet përparësi produkteve të dizajnuara për t'u ricikluar, me reduktim të substancave të dëmshme, me emetime, zhurmë dhe rrezatim të ulët, si dhe me volum minimal paketimi.
Furnizues energjie	Furnizues energjie me miks elektrik të bazuar në burime të rinovueshme.
Makinat	Automjete elektrike; megjithatë, në raste kur përshkohen shpesh distanca të gjata, mund të preferohen hibridet plug-in.
Tekstile	Materiale organike ose të ricikluara dhe produkte që marrin parasysh mirëqenien e kafshëve.
Produkte pastrimi	Produkte me eko-etiketa si EU Ecolabel ose Green Seal, të cilat tregojnë se produkti është i biodegradueshëm, jo toksik dhe i prodhuar nga burime të rinovueshme.
Ushqim	Duhet t'u jepet përparësi furnitorëve lokalë që ndodhen sa më afër për të minimizuar emetimet e karbonit nga transporti. Furnitorët duhet të kenë certifikime të besueshme të qëndrueshmërisë si Organic ose Fair Trade.

4.4 Sistemi i pikëzimit

Sistemi i pikëzimit për furnizuesit e qëndrueshëm bazohet në kriteret e përmendura në seksionin 4.3. Pikëzimi kryhet duke përdorur përgjigjet e dhëna nga furnitori. Të gjitha pyetjet kryesore kanë një metodologji vlerësimi dhe një peshë të caktuar. Më poshtë është formula për këtë llogaritje:

$$\text{Total Score} = (p1 \times w1) + (p2 \times w2) + \dots + (p10 \times w10)$$

ku p është pika e marrë për kriterin specifik dhe w është pesha e kriterit.

Një furnitor konsiderohet “i qëndrueshëm” nëse merr më shumë se 50% të pikëve totale.


4.5 Procesi i vlerësimit

Vlerësimi dhe pikëzimi kërkohen sa herë që vendoset një marrëdhënie me një furnitor të ri ose kur rinovohet një kontratë ekzistuese. Kjo zbatohet nëse nevojat e prokurimit të ProCredit Bank janë identifikuar si “të rëndësishme” pas vlerësimit të rëndësisë në seksionin 4.1.

Rezultatet mbeten të vlefshme për maksimumi pesë vjet nëse nuk komunikohet ndonjë ndryshim nga ana e furnitorit. Së bashku me rezultatet e pyetësorit të nënshkruar, të gjitha dokumentet e mbledhura si prova duhet të ruhen në sistemin lokal. Pas maksimumi pesë vjetësh bashkëpunim me të njëjtin furnitor, vlerësimi duhet të përsëritet.

5. Kërkesat për raportim

Në fund të çdo viti fiskal, informacioni mbi prokurimin e qëndrueshëm mbledhet dhe publikohet në raportin e qëndrueshmërisë së grupit.



ProCredit Bank, Shqipëri
Rruga Dritan Hoxha, Tiranë
Tel: +355 (4) 2 389 389
www.procreditbank.com.al

ProCredit Bank Shqipëri
Të gjitha të drejtat të rezervuara